



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-191/1

Në bazë të nenit 14.10 dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesja e Bordit duke ushtruar kompetencat e tyre emergjente konform nenit 12.1 të Statutit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, me datën 13 Janar 2022, marrin vendimin e mëposhtëm emergjent.

Ky vendim emergjent merret duke pasur parasysh natyrën e urgjencës objektive për të cilën nuk ka qenë e mundur të vendoset në një mbledhje të zakonshme të Bordit, apo duke shfrytëzuar procedurën e vendosjes sipas nenit 9.5 të Statutit të Bordit, duke qenë se dita shpalljeje së SHAL është me 29 nëntor 2023, dhe ky vendim i nënshtrohet ratifikimit të Bordit në takimin e radhës.

Prandaj, Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesi duke vepruar së bashku marrin vendimin si më poshtë:

VENDIM

I. Azhurnohet lista e asetëve për shitje në SHAL 64 me gjithë depozitat e propozuara.

II. Listës së SHAL 64 i largohen asetet si në vijim:

1. Njësia 02 - Motel Drini i Bardhë – NSH NHTT Pashtriku PEJ127
2. Njësia 05 - Bankkos Lokali në Podujeve – NSH BANKKOS PRN125
3. Njësia 08 - Toka në Mirocë - NSH KB Perparimi PRN019
4. Njësia 10-Apiko-Lokali (ish-depo) në Prishtinë _NSH “Apiko” PEJ002
5. Njësia 12 - Bankkos Lokali në Deçan - NSH BANKKOS PRN125
6. Njësia nr.13-Ramiz Sadiku Toka në Obiliq – NSH KNI “Ramiz Sadiku” PRN035
7. Njësia 14 - Mulliri Lokali në Obiliq – NSH IMB MULLIRI PRN113

III. Obligohen Komunitatet përkatëse si dhe NP “Infrakos” që në afat prej 30 ditë nga dita e marrjes së këtij vendimi të marrin vendim mbi shpalljen e interesit publik për asetet të si në paragrafin II të këtij vendimi.

IV. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve dhe Zëvendës Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve;

Kopja e këtij vendimi i dërgohet anëtarëve të Bordit menjëherë pas nënshkrimit.

Bashkangjitur me këtë vendim është memorandumi i paraqitur nga Menaxhmenti i Agjencisë në bazë të cilave informata dhe rekomandime është marrë vendimi dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Prishtinë, 27 /11/2023

Mentor Hyëni

Kryesues
Bordit të Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Syzana Dautaj-Surdulli

Zëvendës Kryesuesja
Bordit të Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-191/2

Në bazë të neneve 14.10 dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenit 12.1 të Statutit të Bordit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30 nëntor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me këtë konfirmon dhe njeh si të vetin, vendimin Nr. Ref. BD-191/1 të datës 27 nëntor 2023 të nënshkruar nga Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesja e Bordit, dhe efekti i të cilit vendim rrjedh nga data e nënshkrimit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Me datën 27 nëntor 2023 Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesja e Bordit kishin nënshkruar vendimin Nr. Ref. BD-191/1 për aprovimin e propozimit të Menaxhmentit lidhur me kërkesën e disa komunave për largim të disa aseteve nga SHAL 64.

Arsyeja pse Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesja kanë marrë këtë vendim emergjent qëndron në faktin se data kur është marrë ky vendim ka qenë afati i fundit në të cilin Agjencia ka mundur të ndërmarrë një veprim të tillë. Për këtë arsye, nuk ka qenë objektivisht e mundur që të mbledhet Bordi për të shqyrtuar dhe marrë këtë vendim, apo që një gjë e tillë të bëhet përmes procedurës me shkrim.

Sa i përket çështjes për të cilën vendimi është marrë, gjegjësisht vendimit emergjent për tërheqje disa aseteve nga SHAL 64 Menaxhmenti ka paraqitur memorandumun me arsyetimet përkatëse para marrjes së këtij vendimi i cili është i bashkangjitur me këtë memorandum. Duke marrë parasysh këto, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 nëntor 2023




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
eëë.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Nr. Ref. BD-191/3

Në bazë të neneve 15.2.15 dhe 20.2 të Ligjit nr. 04/L-034 të Agjencisë (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), bazuar në përgjegjësitë e përgjithshme të Bordit të Drejtorëve, si dhe nenit 43.4 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Agjencive të Pavarura, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30 nëntor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet Plani Vjetor i Punës dhe Performancës i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2024.**
- II. **Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe aprovoi sipas procedurave Plani Vjetor të Punës dhe Performancës i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2024. Plani është në pajtueshmëri me qëllimet dhe planet e Agjencisë të përcaktuara në kornizën ligjore të AKP-së si dhe kërkesat e Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Agjencive të Pavarura.

Gjithashtu, ky plan është hartuar në përputhje me Strategjinë Përmblylëse të AKP-së për periudhën 2022-2024 që reflekton programin e Qeverisë për bartjen e një numri të konsiderueshëm të pronave të NSh-ve (tokave, aseteve tjera të vlefshme) nga administrimi i AKP-së te "Fondi Sovran" i cili pritet të themelohet gjatë vitit 2023 me ligj nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 nëntor 2023.



Mentor Myseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-191/4

Në bazë të neneve 2.1, 6.2, 15.1 të Ligjit të AKP-së; të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 18.1.3 të Shtojcës së po të njëjtit Ligj, nenit 3.13.1 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurën e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 nëntor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit sipas kërkesës së KK Podujevë për ndërmarrjen e veprimeve në lidhje me objektet e vjetra të ndërtuara në parcelën 01427-0 ZK Dumnice e Poshtme, Komuna Podujevë, pronë e NShKooperativa Bujqësore Dumnica, ngastrat kadastrale 707-1, 707-2 dhe 707-4 ZK Bajqinë, dhe ngastrat kadastrale 457-0 ZK Revuq, Komuna Podujevë, pronë e NShKooperativa Bujqësore Flora, për shkak të rrezikshmërisë së lartë që paraqesin këto objekte. Kërkohej dhe në të njëjtën kohë i lejohet KK Podujevë që të bëjë rrënimin e këtyre objekteve dhe pas rrënit të bëjë pastrimin e gjithë hapësirës.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtoreve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e kërkesës nga Komunës e Podujevës, për largimin e objekteve të vjetra të ndërtuara në ngastrat kadastrale 1427-0 ZK Dumnice e Poshtme, ngastrat kadastrale 707-1, 707-2 dhe 707-4 ZK Bajqinë, dhe ngastrat kadastrale 457-0 ZK Revuq, Komuna Podujevë.

Vendimi u aprovua duke u bazuar në faktin se kërkesa e KK Podujevë bazohet në raportin e Inspektoratit të Komunës së Podujevës, i cili ka bërë inspektimin e objekteve të vjetëruara ku është konstatuar që objektet/mbetjet për shkak të vjetërsisë e rrezikojnë jetën e qytetarëve dhe me probabilitet të lartë të rrezikut nga shembja. Poashtu vendimi u aprovua duke u bazuar edhe në konstatimin e AL dhe Menaxhmentit që me lejimin e rrënit do të evitohet shkaktimi i ndonjë rreziku, i cili do mund të kishte pasoja fatale dhe për më tepër do të eliminohet edhe përgjegjësia e AL/Agjencisë në rast se paraqitet ndonjë rrezik i paralajmëruar sipas të vlerësimit të rrezikshmërisë nga ana e Inspektoratit të KK Podujevë.

Duke pasur parasysh sigurinë e banorëve të kësaj lagjeje, duke qenë se mandati i Agjencisë mes tjerash konsiston administrimin e ndërmarrjeve shoqërore, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 nëntor 2023.




Mentor Hysni
Kryesues
Bordi i Drejtoreve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
ee.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Nr. Ref. BD-191/5

Në bazë të nenit 6.1. 4 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së po të njëjtit Ligj, nenit 3.13.1 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore dhe nenit 3 të Rregullores nr. 07/2023 për qiradhënien e aseteve të NSH-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 nëntor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për ndryshim të kontratave të qirasë për qiramarrësit e NSh Tregu, të cilëve i'u ishte rritur shuma e qirasë prej 10% nga shuma totale e qirasë, në emër të pagesës për shërbimet e pastrimit të mbeturinave, në aneks kontratat e periudhës 2022-2023 dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të i nënshkruajë aneks kontratat e qirasë duke i zbritur shumën prej 10% nga totali i shumës së qirasë për qiramarrësit të cilët ishin ngarkuar me këtë rritje në emër të pagesës së shërbimeve të pastrimit.
- II. Autorizohet Autoriteti i Likuidimit që të iniciojë dhe përfundojë procesin e riorganizimit të Ofruesve të Shërbimit të NSh Tregu.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e propozimit për ndryshim të kontratave të qirasë nga ana e AL-së tek NSh Tregu dhe poashtu iniciimin e riorganizimit të OSH-ve të NSh Tregu.

Paragrafi I i vendimit u aprovua duke u bazuar në faktin se duhet të zbritet shuma e 10% e secilës kontratë të qirasë e cila ju ishte ngarkuar me aneks kontratat e nënshkruara në shtator 2022 në emër të pagesës së KRM Pastrimi për kryerjen e shërbimeve të Pastrimit në Treg dhe pasi që AL/AKP ka ndërprerë kontratën për pastrim me KRM Pastrimin, me kërkesë edhe të vetë qiramarrësve të cilët shpreheshin të pakënaqur me shërbimet e pastrimit dhe faktit që ata do të marrin përsipër vetë pagesat për mbeturina, duhet të zbritet shuma prej 10% e rritur në aneks kontratat e kaluara.

Paragrafi II i vendimit u aprovua duke u bazuar në faktin se AL është në proces të riorganizimit të OSH-ve dhe përmes këtij riorganizimi dhe angazhimit/kontraktimit të mundshëm të ndonjë kompanie private të sigurimit e cila është kërkesë e përsëritur e Qiramarrësve, si pasojë edhe e mungesës së sigurisë do të zvogëlohet edhe numri i OSH-ve. Në rast nevojë, Autoriteti i Likuidimit do të parasheh edhe mundësinë e hapjes së konkursit për angazhimin e OSH-ve. Kontratat e tanishme të Ofruesve të Shërbimeve skadojnë më 31 dhjetor 2023 dhe Autoriteti i Likuidimit para skadimit të këtyre kontratave duhet të gjithë hapat e nevojshëm dhe t'i njoftojë edhe OSH-të për mos-vazhdim eventual të këtyre kontratave me kohë.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Duke qenë se mandati i Agjencisë mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe gjenerimit të hyrave, për ndërmarrjet që janë nën administrimin e Agjencisë dhe duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 nëntor 2023.



Mentor Hyseni

Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-191/6

Në bazë të neneve 5.2 dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, dhe nenit 8 të Ligjit për Pyjet Nr.08/L-137, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 nëntor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet largimi nga autoriteti dhe administrimi i AKP-së si dhe dorëzim-pranimi, i të gjitha Ekonomive Pyjore dhe Ekonomive të Gjuetisë si dhe i të gjitha pronave që evidentohen në emër të "Ekonomia Pyjore" apo "Ekonomia e Gjuetisë".
- II. Menaxhmenti, të koordinoj ngushtë me Agjencinë Pyjore dhe Agjencinë Kadastrale të gjitha veprimet, sigurimin e informatave që mungojnë si dhe të sigurohemi që do të ketë koordinim me Agjencinë Pyjore të Kosovës me rastin e hartimit të akteve nënligjore për interpretimin e saktë të neneve të caktuara për të cilat kemi dilema në mënyrë që dorëzim-pranimi të jetë sa më korrekt, i plotë dhe i saktë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e propozimit për pranim dorëzim të Ndërmarrjeve Shoqërore "Ekonomitë Pyjore" dhe "Ekonomitë e Gjuetisë" nën administrimin e AKP-së

Vendimi u aprovua duke u bazuar në faktin se Ligji mbi Pyjet Nr.08/L-137 i cili ka hyrë në fuqi me datë 24.03.2023 në nenin 8 të tij përcakton si në vijim:Neni 8. Pronësia mbi pyllin dhe tokën pyjore

1. Pyjet, tokat pyjore dhe kullotat në pronësi shtetërore, publike apo shoqërore, Ekonomitë Pyjore, Ekonomitë e Gjuetisë dhe Ndërmarrjet Shoqërore të regjistruara sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Shoqërore - (Gazeta Zyrtare Nr. 77/88), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 40/89, 46/90 dhe 61/90 apo Organizatat Themelore të Punës së Bashkuar (OTHPB): "Ekonomia Pyjore" - Shumsko Gazdinstvo" apo çfarëdo emërtimi tjetër që ishte regjistruar si pronar ose shfrytëzues i pronës shoqërore, shtetërore apo publike dhe është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, janë pronë e Republikës së Kosovës me të cilën menaxhon Agjencia. Gazeta zyrtare e republikës së Kosovës / nr. 9 / 3 prill 2023, Prishtinë 6 ligji nr.08/L-137 për pyjet.

2. Pyjet dhe tokat pyjore shtetërore regjistrohen me pronarë Qeveria e Republikës së Kosovës. Meqë Ndërmarrjet e mësipërme janë të regjistruara si NSh në listën e Ndërmarrjeve në Administrim të AKP-së bazuar në Ligjin e lartcekur nuk menaxhohen nga AKP por janë pronë Republikës së Kosovës me të cilën menaxhon Agjencia Pyjore e Kosovës. Duke u bazuar në ato që u tha më lartë, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 nëntor 2023:



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
ee.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-191/7

Në bazë të neneve 6.1.1, 6.1.2 dhe 15.1 dhe 15.2.3 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Nenit 5 të Rregullores nr.05-2022 - për përgjegjësitë e Bordit dhe Drejtorit Menaxhues të Nsh Inex Sharr Planina në Brezovicë, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare në mbledhjen e mbajtur me datë 30 nëntor 2023 nxjerr këtë:

VENDIM

- I. **Aprovohet shpallja e konkursit publik për emërimin e Drejtorit Menaxhues të Nsh Inex Sharr Planina në Brezovicë.**
- II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Menaxhmentit të Agjencisë për performancën e Drejtorit Menaxhues aktual të Nsh Inex Sharr Planina në Brezovicë dhe njëkohësisht propozimin për shpallje të konkursit publik për rekrutim pasi që ti kaloj mandati DM aktual.

Bordi u bazua në faktin se ka sipas raportit të prezantuar rezultun se katër (4) nga pesë (5) antarët e Bordit të ndërmarrjes nuk janë të kënaqur me punën e drejtorit aktual dhe rekomandojnë shpalljen e konkursit publik për rekrutim dhe duke qenë se ka mendime të ndryshme në këtë drejtim më e arsyeshme shihet shpallja e konkursit.


Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 nëntor 2023





Mentor Hysni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-191/8

Në bazë të nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, dhe Rregullores nr. 07/2023 për qiradhënien e aseteve të NSh-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 nëntor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohen rekomandimet e Menaxhmentit të rezultateve të qiradhënies përmes shpalljes publike, sipas listës së bashkangjitur.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për aprovim të çmimeve të ofertimit nga qiradhënia e aseteve përmes shpalljes publike për asetet e NSh Jatex, Gjakovë sipas rezultateve të datës 14 nëntor 2023.

Vendimi u aprovua duke u bazuar në faktin se dhënia eventuale me qira e aseteve në fjalë do ti shërbente rritjes së të ardhurave të gatshme për NSh Jatex, Gjakovë në mënyrë që të lehtësohet gjendja financiare e punëtorëve të Ndërmarrjes dhe me qëllim që ti kryejnë obligimet financiare ndaj ATK-së, shpenzimeve të rrymës, ujit, pagave dhe shpenzimeve të tjera.

Mandati i Agjencisë mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe gjenerimit të hyrave, kësaj here përmes qiradhënies publike, për ndërmarrjet që janë nën administrimin e Agjencisë dhe duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 nëntor 2023.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Lista e Aseteve për qirathënie të Aseteve të NSH-ve në AD përmes siparshies publike e dates 14 nëntor 2023

[illegible]



Nr. Ref. BD-191/9

Në bazë të neneve 6.14 dhe 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, dhe 18.1.3 dhe 18.15 të Shtojcës së po të njëjtit Ligj, nenit 3.13.1 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, nenit 10.1.5 të Rregullores nr. 07/2023 për qiradhënien e aseteve të NSh-së, dhe neneve 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 nëntor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit dhe lejohet ndryshimi/korrigjimi i sipërfaqes së asetit P-71712062-00339-4 ZK Podujevë, i njohur si Parkingu Podujevë, pronë e KB Përparimi, ashtu që si sipërfaqe për kontratat e ardhshme të qirasë për pjesën e parkingut të llogaritet sipërfaqja prej 2269 m².
- II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së dhe Autoriteti i Likuidimit që të ndërmerrë të gjitha procedurat për qiradhënie sipas çmimit aktual i cili nuk ndryshohet.
- III. Borxhi i mbetur për më pak se 33 muaj të papaguar do të i llogaritet në bazë të cmimit aktual për sipërfaqen prej 2269 m², dhe do të obligohet pala që para lidhjes së marrdhënies kontraktuale të qirasë të bëjë riprogramimin e borxhit.
- IV. Nëse pala nuk pranon kushtet e AKP-së, prona të lirohet sipas procedurave dhe të ndërmerren veprimet gjyqësore për qiranë e pa paguar dhe të vendoset në tender publik për qiradhënie.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovim të kërkesës për korrigjim të sipërfaqes për asetin P-71712062-00339-4 i cili është objekt i kontratës së qirasë me Z. Alben Mehmeti (tanimë shfrytëzues pa kontratë i asetit) dhe kërkesë për iniciimin e procedurave të qiradhënies për asetin pronë e KB Përparimi PRN019.

Vendimi u aprovua duke u bazuar në faktin se në kontratën bazë të qirasë me nr. protokollin 7627-2015, sipërfaqja e cila ishte përshkruar për shfrytëzim ishte 4951 m² për shumën totale prej 2,002.00 €. Në shpalljen publike për qiradhënie përmes tenderit më datë 03.08.2015, ky aset ishte përshkruar si njësi me sipërfaqe prej 4981 m², por ajo çfarë mund të vërehet është që me shkresën 7529-2015 të datës 28.08.2015 të dërguar nga ana e Zyrtarit të Rastit si njoftim për ish-qiramarrësin që është miratuar oferta e tij, thuhet që i është aprovuar kontrata e qirasë për sipërfaqen prej 2650 m². Kështu, ka dallime në mes të njoftimit të dërguar tek ish-qiramarrësi për aprovim të ofertës së tij, ku është cekur se oferta i është aprovuar për sipërfaqen prej 2650 m² dhe kontratës së qirasë në të cilën është vendosur sipërfaqja prej 4951 m², ndërsa në shpalljen publike të datës 24.06.2015 është paraqitur për ofertë për sipërfaqen prej 4981 m² (e përshkruar si Njësia 1 në shpalljen publike të bashkëngjitur si shtojcë). Nga kjo mund të nënkuptohet se ish-qiramarrësi ka ofertuar shumën prej 2,002.00 EUR për sipërfaqen e përshkruar për Njësinë 1, apo konkretisht sipërfaqen prej 4981 m².

Për më tepër, AKP pas mos-vazhdimit të kontratës së qirasë dhe borxhit të ish-qiramarrësit ka kërkuar disa herë lirimimin e asetit, mirëpo ky aset nuk ka arritur të lirohet asnjëherë. Megjithatë, në mënyrë që të zgjidhim këtë çështje, është angazhuar gjeodeti i licencuar z. Petrit Islami, në mënyrë që të bëjë matjet e sakta dhe të paraqesë skicën e sipërfaqes të cilën qiramarrësi, z. Alben Mehmeti e ka në shfrytëzim. Megjithatë, tani pas angazhimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

të Gjeodetit të licencuar, kemi edhe skicën si dhe sipërfaqen e saktë e cila është në shfrytëzim nga qiramarrësi. Sipërfaqja totale që është në shfrytëzim faktik nga ana e qiramarrësit është 2269 m². Nga kjo mund të kuptohet se pasi që sipërfaqe e shfrytëzueshme janë vetëm 2269 m², ish-qiramarrësit me kontratën e qirasë i ishin ngarkuar 2682 m² më tepër, të cilat në kontratë janë përcaktuar si rrjedhë edhe e shpalljes publike për qiradhënie përmes tenderit publik.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me shfrytëzuesin do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Bazuar në gjithë dokumentacionin që e posedojmë si Agjenci në lidhje me rastin e sipër-përshkruar, shkresat/kërkesat, përgjigjet e pranuar nga pala ish-qiramarrëse, mund të konkludojmë se ekzistojnë të gjitha kushtet që të shkohet me procedurat për arritjen e marrëveshjes për qiradhënie mes AKP/AL të NSh KB Përparimi PRN019 (Në Likuidim) si qiradhënëse në njërin anë, si dhe z. Alben Mehmeti nga Podujeva, qiramarrës i tokës që është pjesë e ngastrës kadastrale 00339-4 me sipërfaqe të saktë që është në shfrytëzim (bazuar nga matjet dhe skica e realizuar së fundmi nga gjeodeti i licencuar i angazhuar nga AKP/AL) është në total prej 2269 m².

Mandati i Agjencisë mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe gjenerimit të hyrave, ndërmarrjet që janë nën administrimin e Agjencisë dhe duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padë pranë Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 nëntor 2023.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-191/10

Në bazë të neneve 6.14 dhe 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, dhe 18.1.3 dhe 18.15 të Shtojcës së po të njëjtit Ligj, nenit 3.13.1 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurën e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, nenit 10.1.5 të Rregullores nr. 07/2023 për qiradhënien e aseteve të NSh-së, dhe neneve 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 nëntor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për ndryshim të vendimit të Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-174/58 të datës 23 dhjetor 2022, ashtu që në vend të Kompanisë "PRISIG" si qiradhënës të paraqitet shfrytëzuesi aktual, Florie Vllasa për qiradhënie direkte të sipërfaqes prej 16.5 m² të parcelës 00339-5 ZK Podujevë në pronësi të NSh "KB Përparimi" PRN019, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 180.00 për një muaj.
- II. Para lidhjes së marrëdhënies kontraktuale Qiramarrësi është i detyruar të paguajë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, shumën prej € 8,460.00 për periudhën e shfrytëzimit të 3 viteve të fundit të parcelës në mënyrë të paautorizuar. Në këtë shumë përpos periudhës së 3 viteve të fundit të shfrytëzimit është e përfshirë edhe periudha nga 1 janar 2023 – 30 nëntor, periudhë për të cilën në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-174/58 të datës 23 dhjetor 2022, do të duhet të ishte lidhur kontrata e qirasë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovim të kërkesës për korigjim/ndryshim të vendimit të Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-174/58 të datës 23 dhjetor 2022 në lidhje me qiradhënien e asetit të PRN019 NSh Përparimi, Podujevë. Vendimi u aprovua duke u bazuar në faktin është ndryshimi i vendimit të lartëcekur të Bordit të Drejtorëve, ashtu që të ndryshohet në raport me qiramarrësin, sepse pas konstatimit të drejtë të gjendjes faktike është kuptuar që shfrytëzuesi aktual dhe i mëhershëm i pjesës prej 16.5 m² të parcelës 00339-5 ZK Podujevë, është Rrahman Vllasa, konkretisht hapësira në fjalë shfrytëzohet tanimë nga familja e tij, e reja e tij, Florie Vllasa, e cila ushtron veprimtari biznesore në objektin e vendosur në parcelën e lartëcekur, dhe kështu janë parashtruar disa herë kërkesa për qiramarrje të asetit dhe së fundi pas kërkesave për lirim të asetit për Kompaninë PRISIG pasi që nuk është paraqitur për të nënshkruar marrëveshjen kontraktuale, ka paraqitur përsëri kërkesë për qiramarrje dhe ka kërkuar që kontrata të lidhet me të, pasi që ai është shfrytëzues faktik i asetit. Mandati i Agjencisë mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe gjenerimit të hyrave, ndërmarrjet që janë nën administrimin e Agjencisë dhe duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 30 nëntor 2023.




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
eee.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-191/11

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Nenit 2.5 i Kontratës së Qirasë me nr. protokoli 14640/2018 në mes të "NSH LUX", Mitrovicë dhe Momir Popović dhe nenit 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrime, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 nëntor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet transferimi i Kontratës së Qirasë për shfrytëzimin e Lokalit afarist DAFINA 2/2 nga Momir Popović tek Žanka Popović me qira mujore në lartësinë prej 78.14 EUR për asetin e NSH Lux.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferrin e kontratës së qirasë sipas diapozitivit të këtij vendimi.

Më 08.11.2023 Agjencia ka pranuar shkresën me nr. protokoli 5244/2023, nga personi fizik Žanka Popović e cila kërkon që të bëhet ndërrimi i qiramarrësit nga Momir Popović tek Žanka Popović, kjo për arsye se qiramarrësi Momir Popović me datën 25.09.2023 ka ndërruar jetë. Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit e pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësi nuk ka borxhe, duke mundësuar kështu rritjen ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Kjo kontratë është rivlerësuar nga Bordi përmes vendimit nr. BD-175/16 të datës 27.01.2023. Kjo kontratë që nga koha e lidhjes është vazhduar pa ndërprerje deri me sot, si dhe qiramarrësi ka qenë i rregullt me pagesa, e ka bërë edhe pagesën e shumës së rivlerësuar. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 nëntor 2023.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
ee.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-191/12

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Nenit 2.5 të Kontratës së qirasë me nr. të protokollit 1942/2021 të datës 31.08.201 ne mes të AL të NSh "Virxhinia" dhe Ferid Morina dhe nenit 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrime, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 nëntor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet kërkesa e palës Ferid Morina për transferin e kontratës së qirasë për asetin "Hangari" pronë e NSh Virxhinia, tek "Premium Furniture Shpk" me bashkëpronar/përfaqësues z. Ferid Morina për asetin e NSh Virxhinia.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratës së qirasë sipas diapozitivit të këtij vendimi.

Vendimi u aprovua duke u bazuar në faktin se pala Ferid Morina ka qenë qiramarrës i asetit të NSh "Virxhinia" i njohur si "Hangari" në Gjakovë, me sipërfaqe prej 500 m², i cili ka paraqitur kërkesë me datë 08.11.2023 me numër të protokollit 272/2023 IN, përmes së cilës kërkon që të i lejohet transferimi i kontratës së qirasë nga Ferid Morina tek "Premium Furniture Shpk" me seli në Gjakovë, ku i njëjti është bashkëpronar/përfaqësues i firmës. Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit e pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësi nuk ka borxhe, duke mundësuar kështu rritjen ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Kjo kontratë e qirasë është lidhur më datë 01 shtator 2020, dhe ka qenë kontratë e qirasë e trashëguar nga ish Menaxhmenti i Ndërmarrjes. Meqenëse ka qenë subjekt i rivlerësimit dhe qiramarrësi është pajtuar me çmimin pas rivlerësimit atëherë ka parashtruar kërkesë për transferim të qirasë tek firma e tij private. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 nëntor 2023.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-191/13

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Neni 2.5 i Kontratës së Qirasë me nr. protokollit 45252/2023-OUT në mes të NSh "IMF Kosova" Fushë Kosovë dhe qiramarrësit Din Ferizi dhe nenit 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrime, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 nëntor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet transferimi i Kontratës së Qirasë për shfrytëzimin e lokalit në Rruga Nazim Gafurri Komuna e Prishtinës, me sipërfaqe prej 70 m², me qira mujore prej 365.34 EUR për asetin e NSh "IMF Kosova" Fushë Kosovë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferimin e kontratës së qirasë sipas diapozitivit të këtij vendimi.

Vendimi u aprovua duke u bazuar në faktin se pala Din Ferizi është Qiramarrës i lokalit me sipërfaqe prej 70 m² që nga dt. 27.01.2014. Tanimë lokali është duke u shfrytëzuar sipas Aneks Kontratës së Qirasë nr. 45252/2023-OUT për periudhën kohore 01.03.2023 - 29.02.2024. Ky aset ka hyrë në qiradhënie e trashëguar nga ish-Menaxhmenti i Ndërmarrjes. Më 02.08.2023 Zyra Rajonale e Prishtinës ka pranuar shkresën me nr. protokollit 22881/2023-IN nga personi z.Din Ferizi, i cili kërkon që të bëhet ndërrimi i emrit të firmës poashtu që Kontrata të jetë në emër të djalit të tij z. Arber Ferizi si përfaqësues i kompanisë, për shkak se z. Din Ferizi ka arritur moshën e pensionimit dhe nuk është mjaft mirë me shëndet. Kjo kontratë që nga koha e lidhjes është vazhduar pa ndërprerje deri me sot, si dhe qiramarrësi ka qenë i rregullt me pagesa. Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit e pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësi nuk ka borxhe, duke mundësuar kështu rritjen ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Kjo kontratë e qirasë është lidhur më datë 01 shtator 2020, dhe ka qenë kontratë e qirasë e trashëguar nga ish Menaxhmenti i Ndërmarrjes. Meqenëse ka qenë subjekt i rivlerësimit dhe qiramarrësi është pajtuar me çmimin pas rivlerësimit atëherë ka parashtruar kërkesë për transferim të qirasë tek firma e tij private. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 nëntor-2023




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
ee.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-191/14

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 3.13.1 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, dhe Rregullores nr. 07/2023 për qiradhënien e aseteve të NSH-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 nëntor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për instalimin e autolarjes mobile vetë-shërbyese në kuadër të pronës apo pompës së derivateve të naftës që gjendet në Rr. Prishtinë - Fushë Kosovë, afër "FSK"-ës cila shtrihet në parcelat kadastrale nr.1498-5 dhe 1499-2 Z.K Prishtinë.
- II. Për instalimin e kësaj autolarje, qiramarrësi të ngarkohet me vlerë shtesë apo rritje të qirasë aktuale për 300€ sipas rekomandimit të AL-së.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për shqyrtimin e kërkesës së "IP KOS" shpk për dhënien e pëlqimit për vendosjen e autolarjes vetë-shërbyese në pompën e derivateve të naftës që gjendet Rr. Prishtinë-Fushë Kosovë, afër "FSK"-ës, në pronësi të NSH OTHPB DN "INA" Prishtinë (PRN149).

Vendimi u aprovua duke u bazuar në faktin se me datë 04.08.2023 qiramarrësi ka parashtruar kërkesë me të cilën i është drejtuar Autoritetit të Likuidimit duke kërkuar që ti jepet pëlqimi për vendosjen e autolarjes mobile vetë-shërbyese në pikën shitëse të derivateve të naftës të lartpërmendur. Në këtë kërkesë është sqaruar se autolarja do të ketë karakter të përkohshëm e cila mund të largohet kurdoherë në veçanti me rastin e ndërprerjes së kontratës, është e tipit vetë-shërbyes si dhe konstruksioni do të jetë prej metali dhe nuk do të ketë ndërhyrje në objekt apo stabilimente tjera. Gjithashtu qiramarrësi thekson në kërkesë se është i vetëdijshëm dhe nuk merr për bazë asnjë lloj kompensimi për investimin e bërë në këtë autolarje në rast të ndërprerjes së kontratës dhe se është i obliguar të kthejë pronën në gjendjen e mëparshme pa e dëmtuar. Sipas vlerësimit të AL-së i kësaj kërkesë të qiramarrësit do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore shtesë duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 nëntor 2023.




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
ee.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Nr. Ref. BD-191/15

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, nenit 42 të Ligjit nr. 03/154 për Pronësinë dhe të drejtat sendore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 nëntor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga aset nr. P-71914059-05830-0 me sipërfaqe prej 269 m² ZK Prishtinë dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aset në pronësi të NSh "Radio Televizioni i Prishtinës" PRN150.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhomë e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetit respektivisht nga ngastrat kadastrale nr. P-71914059-05830-0 me sipërfaqe prej 269 m² ZK Prishtinë në pronësi të NSh "Radio Televizioni i Prishtinës" PRN150.

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se në këtë parcelë nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana e Autoritetit të Likuidimit/AKP-së, për shkak se në tërësi të parcelës është ndërtuar një ndërtesë e cila shfrytëzohet për më shumë se pesëdhjetë vite nga ana e banorëve që jetojnë aty. Për më tepër, Autoriteti i Likuidimit/AKP nuk posedon ndonjë dëshmi apo dokument pronësor që do të provonte faktin që NSh "RTP" është pronare e objektit. Duke qenë në këtë gjendje është e pa mundur që të shitet apo pronësia të realizohet në formë të tjera, dhe për këtë arsye është kërkuar që të heqet dorë nga ky aset.

Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shites së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 nëntor 2023



Mentor Hyseni

Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-191/16

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, nenit 42 të Ligjit nr. 03/154 për Pronësinë dhe të drejtat sendore, Nenit 11 të Ligjit nr. 2003/11 për Rugët, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 nëntor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprobohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga aset nr. P-71914059-06306-0 me sipërfaqe prej 402 m² ZK Prishtinë dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aset në pronësi të NSh "Radio Televizioni i Prishtinës" PRN150.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetit respektivisht nga ngastrat kadastrale nr. P-71914059-06306-0 me sipërfaqe prej 402 m² ZK Prishtinë në pronësi të NSh "Radio Televizioni i Prishtinës" PRN150.

Autoriteti i Likuidimit arriti në përfundim se në këtë parcelë nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana e Autoritetit të Likuidimit/AKP-së, për shkak se në tërësi të parcelës është ndërtuar një ndërtesë e cila shfrytëzohet për më shumë se pesëdhjetë vite nga ana e banorëve që jetojnë aty dhe janë të ndërtuara rrugë dhe trotuare që ju shërbejnë banorëve të këtij objekti për qasje në rrugë dhe banorëve tjerë përreth për qarkullim. Për më tepër, Autoriteti i Likuidimit/AKP nuk posedon ndonjë dëshmi apo dokument pronësor që do të provonte faktin që NSh "RTP" është pronare e objektit. Duke qenë në këtë gjendje është e pamundur që të shitet apo pronësia të realizohet në formë tjetër, dhe për këtë arsye, është kërkuar që të hiqet dorë nga ky aset.

Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 nëntor 2023



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-191/17

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 nëntor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga depoja e rrënuar e cila kishte shërbyer si bazë e derivateve të naftës për NSh "Jugopetrol" PRN170 dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aset.
- II. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga aset i respektivisht nga depoja e rrënuar e cila kishte shërbyer si bazë e derivateve të naftës për NSh "Jugopetrol" PRN170.


Autoriteti i Likuidimit ka raportuar se depoja e NSh "Jugopetrol" PRN170 e ndërtuar në parcelën 0835-2 ZK Fushë Kosovë ("Hekurudhave të Kosovës") është e rrënuar e tëra dhe në bazë të raportit të gjendjes në terren tanimë në këtë parcelë në pronësi të "Hekurudhave të Kosovës" (Infrastruktura e Hekurudhës) konfirmohet fakti që ky aset është i shkatërruar që nga viti 1999 dhe kështu Autoriteti i Likuidimit arriti në përfundim se aset nuk është fitimprurës dhe gjithashtu për shkak të mos ekzistencës tanimë të kësaj depeje nuk mund të ushtrohet kontrolli efektiv. Duke qenë në këtë gjendje është e pa mundur që të shitet apo pronësia të realizohet në formë të tjera, dhe për këtë arsye është kërkuar që të heqet dorë nga ky aset. Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 nëntor 2023.




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-191/18

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 2 dhe nenit 3.6.5 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 nëntor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për NewCo XIM Strezovci” GJI170 (në likuidim) që konsiderohet i domosdoshëm për finalizimin e procesit të likuidimit në shumë prej € 36,000.00 dhe atë për vijën buxhetore si në vijim:
 1. e19 (Tatimi i të ardhurave personale për Ofruesit e Shërbimeve), në vlerë prej € 6,000.00;
 2. e22 (Shërbimet për mbrojtjen e pronës dhe aseteve), në vlerë prej € 30,000.00;
- II. Autorizohet Departamenti i Buxhetit dhe Financave të AKP-së të përfshijë ndryshimet e miratuara buxhetore për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për Rritja e buxhetit të likuidimit të NSH “Lola Korporacija” GJI063.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ende nevojitet buxhet për Shërbimet për mbrojtjen e pronës dhe aseteve dhe Tatimin në të ardhura personale për Ofrues të Shërbimeve në vlerë prej € 36,000.00 pasi që ende nuk kanë përfunduar procedurat e likuidimit për NewCo XIM Strezovci” GJI170.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 nëntor 2023



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-191/19

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 3.13.1 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, dhe Nenit 252 – 260 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 nëntor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e FA Hoti përfaqësuar nga Agron Hoti, pronar i parcelës nr.511-2 për vendosjen e kabllave elektrike nëntokësore përmes parcelës 511-3 ZK Klinë, pronë e NSH Malishgani e cila do të shërbejë për furnizim me energji elektrike vetëm për parcelën nr. 511-2 dhe objektet e ndërtuara në të.
- II. Obligohet parashtruesi i kërkesës që vendosjen e kabllave elektrike nëntokësore ta bëjë në atë mënyrë që të ngarkojë sa më pak që është e mundur parcelën 511-3 ZK Klinë dhe pas vendosjes së kabllave elektrike nëntokësore të bëjë kthimin në gjendjen e mëparshme.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovim të kërkesës për lejimin e vendosjes së kabllave elektrike nëntokësore përmes parcelës 511-3 ZK Klinë pronë e NSH Malishgani.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se pala Agron Hoti ka paraqitur kërkesë me datë 19.09.2023 me numër të protokollit 212/2023 IN, përmes së cilës kërkon që të i lejohet që përmes parcelës nr. 511-3 ZK Klinë, pronë e NPB Malishgani (e cila nuk është e dhënë me qira), të i vendos kabllot elektrike nëntokësore sipas standardeve dhe parametrave të përcaktuara nga ana e KEDS. Në kuadër të kësaj parcele është i ndërtuar stadiumi i qytetit me objektet përcjellëse, ndërsa komuna ka parashtruar kërkesë për shpronësimin e kësaj prone.

Sipas vlerësimit të AL-së, vendosja e kabllave elektrike nëntokësore përmes parcelës me nr. 511-3 nuk dëmton parcelën pronë e NSH Malishgani, pasi që kërkuuesi pasi përfundon procesin, do ta kthejë parcelën në gjendjen e mëparshme. Në rast që nuk bëhet kthimi në gjendje të mëparshme, sipas edhe vetë zotimit të parashtruesit të kërkesës, atëherë Autoriteti i Likuidimit do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore në mënyrë që të realizojë kompensimin e dëmit dhe kthimin në gjendje të mëparshme të parcelës nr. 511-3 ZK Klinë.

Poashtu ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se parcela e palës nr.511-2 është në fqinjësi me parcelën nr. 511-3 ZK Klinë dhe pothuajse e vetmja zgjidhje që të bëhet shtrirja e gypave është që të bëhet përmes parcelës në pronësi të NSH Malishgani,.

Dhënia e pëlqimit në këtë rast mund të arsyetohet edhe në bazë të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, ku parashihet mundësia e krijimit të servitutit sendor (nga neni 252 deri 260 e këtij Ligji) dhe në këtë rast parcela nr. 511-3 ZK Klinë na paraqitet si paluajtshmëri shërbyese në të cilën do të vendosen kabllot elektrike të cilat do të shfrytëzohen për konsum familjar nga banorët të cilët do të jetojnë në banesat e ndërtuara në parcelën nr.511-2 të cilat është ndërtuar nga ana e parashtruesit të kësaj ndërtese.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 nëntor 2023.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit